



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Kontrolli i Lartë i Shtetit

# RAPORT MONITORIMI VITI 2025

## Plani Strategjik 2023-2027



Përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë dhe Planifikimit Strategjik

# PËRMBAJTJA

01

Hyrje

02

Rëndësia e monitorimit të objektivave

03

**Qëllimi 1**

Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike

04

**Qëllimi 2**

Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve

05

**Qëllimi 3**

Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese

06

**Objektivat e perealizuara dhe në proces**

07

Anekse

## HYRJE

Kontrulli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Strategjia e Zhvillimit të KLSH - së 2023-2027, dokumenti strategjik më i rëndësishëm i institucionit, i cili në linjë me misionin e tij, e udhëheq Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional, duke ju përshtatur dhe përgjigjur në kohë dhe me përgjegjshmëri dinamikave dhe zhvillimeve lokale dhe globale, ka përfunduar tashmë vitin e tretë të zbatimit të tij i cili përkon edhe me 100-vjetorin e KLSH-së.

Në këtë 100-vjetor, KLSH vijon përmbushjen e misionit të tij kushtetues me përkushtim, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale, duke forcuar rolin e tij si institucioni suprem i auditimit në shërbim të interesit publik.

Edhe gjatë vitit 2025, zbatimi i Strategjisë është zberthyer në nënobjektiva dhe aktivitete, nëpërmjet të cilave institucioni ka synuar rritjen e cilësisë së auditimeve, duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme dinamikave në përputhje kjo edhe me ISSAI-të, në veçanti sa i takon ndërtimit të një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë së

auditimit plotësisht në përputhje me ISSAI 140; konsolidimit të praktikave të planifikimit vjetor dhe operacional sipas metodologjive të përditësuara; konsolidimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me Kuvendin dhe Nënkomisionin Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik nëpërmjet dëgjësave parlamentare dhe raportimeve të vazhdueshme; përdorimit të vizualizimeve për të përmirësuar efikasitetin e përcjelljes së punës audituese; si dhe komunikimit të rezultateve të auditimeve dhe veprimtarisë së KLSH nëpërmjet mediave sociale, prezencës në shtypin e shkruar dhe atë audioviziv, si dhe nëpërmjet broshurave, buletineve dhe aktiviteteve

Me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike, nënobjektivave dhe aktiviteteve përkatëse, KLSH ka hartuar planin e veprimit për implementimin e strategjisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023, i cili ka vijuar të zbatohet edhe përgjatë vitit 2025. Ky plan është monitoruar në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit. Monitorimi i kësaj strategjie, ka kërkuar nga ana e KLSH – së angazhimin e vazhdueshëm të të gjitha strukturave të institucionit në drejtim të realizimit të aktiviteteve specifike të planit të veprimit dhe raportimin mbi rezultatet e arritura nga ky zbatim.

Për këtë arsye, ky raport monitorimi synon të identifikojë dhe vlerësojë statusin e zbatueshmërisë së objektivave strategjike sipas planit të veprimit për vitin 2025, njësitë përgjegjëse për secilin objektiv dhe veprimet e ndërmarra nga to për realizimin e objektivave përkatëse, si dhe afatin e përmbushjes së tyre.



# RËNDËSIA E MONITORIMIT TË QËLLIMEVE & OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

“ KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.



Në përmbushje të misionit dhe vizionit të tij, KLSH ka përcaktuar tre qëllime strategjike që udhëheqin punën e institucionit, realizimi i të cilëve është kritik dhe monitorohet periodikisht.

## Qëllimi Strategjik 1


Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.

## Qëllimi Strategjik 2


Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

## Qëllimi Strategjik 3

Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.



Gjatë vitit 2025, rezulton se janë realizuar 95% e objektivave të përcaktuara (sipas Treguesve të Performancës të detajuar). Monitorimi i vazhdueshëm i arritjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike, është i rëndësishëm pasi na siguron:



Infografik: % e objektivave të realizuara, viti 2025

- ✓ Përafrim me misionin dhe qëllimet
- ✓ Përmirësim të vazhdueshëm
- ✓ Përshtatshmëri ndaj dinamikave
- ✓ Shfrytëzim efektiv të burimeve

# QËLLIMI 1



## **RRITJA DHE PËRMIRËSIMI I ROLIT TË KLSH SI MBËSHTETËS I KUVENDIT PËR LLOGARIDHËNIE EFEKTIVE DHE SHQYRTIM TË KUJDESSHËM E TË THELLUAR TË ENTEVE PËRDORUESE TË FONDEVE PUBLIKE**


KLSH dhe Kuvendi, si dy nga komponentët kryesorë të sistemit të llogaridhënies, kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive. Si partnerë kryesorë në promovimin e qeverisjes së mirë, të dy institucionet luajnë një rol kyç në strukturën e qeverisjes së vendit tonë. Kuvendi mund të kryejë funksionet e tij jetike të mbikëqyrjes së aktivitetit qeveritar në mënyrë më efektive dhe efikase, kur ai përdor dhe mbështetet në punën audituese të KLSH-së. Auditimet e kryera nga KLSH ofrojnë një bazë të fortë dhe të besueshme për Kuvendin për të mbikëqyrur veprimtarinë ekzekutive dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese ku është e nevojshme. Nga ana tjetër, diskutimi i raporteve të auditimit në Kuvend dhe në Nënkomisionin për Auditimin e Sektorit Publik nxit ndërgjegjësimin dhe llogaridhënien e ndërsjellët midis Kuvendit, KLSH-së dhe Ekzekutivit, nëpërmjet dialektikës së të cilëve, informohet publiku i gjerë mbi rezultatet e punës së gjithësecilit, dhe sigurohet transparencë e shtuar në lidhje me përdorimin e fondeve publike.

Gjatë vitit 2025, nëpërmjet punës audituese, KLSH ka synuar të sigurojë një rritje të rolit të tij, si institucioni suprem auditimi në mbrojtje të financave publike në vendin tonë. Duke përmirësuar performancën e vet institucionale audituese, KLSH ka dhënë kontributin e vet në përfitimin e taksapaguesve, duke rekomanduar vazhdimisht që fondet publike përdoren në mënyrë të drejtë dhe efikase, dhe duke mbështetur Kuvendin në shqyrtimin e thelluar të punës së ekzekutivit.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet tre objektivave të mëposhtme:

- 1.1** Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore
- 1.2** Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit
- 1.3** Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin

# 1.1 Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore



## 1 Metodologjia e Planifikimit Vjetor të Auditimeve

Edhe për vitin 2025, planifikimi vjetor i auditimeve realizohet në përputhje me “Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimit”, e cila është hartuar me qëllim mbështetjen e procesit të planifikimit dhe përzgjedhjes së temave të auditimit mbi bazë risku. Kjo metodologji synon orientimin e veprimtarisë audituese drejt fushave dhe subjekteve që paraqesin nivel më të lartë risku, duke siguruar një mbulueshmëri sa më efektive të auditimeve në sektorët me rëndësi të veçantë për administrimin dhe performancën e fondeve publike. Metodologjia është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 166, datë 26.09.2023, i ndryshuar me Vendimin nr. 94, datë 04.06.2025, dhe shërben si dokument udhëzues për një proces të unifikuar dhe efektiv të planifikimit vjetor të auditimeve.

## 2 Përzgjedhja e auditimeve mbi bazë risku

Në kuadër të hartimit të planit vjetor të auditimeve për vitin 2025, të gjitha departamentet e auditimit kanë zhvilluar workshope, ku audituesit kanë propozuar tema auditimi, dhe më pas vlerësimi e përzgjedhja e tyre është bërë duke përdorur metodologjinë e mësipërme. Departamenti i Auditimit të Performancës, vlerësimin dhe përzgjedhjen e temave të auditimit e ka kryer bazuar gjithashtu në Udhëzuesin e Fushave me Risk e rishikuar në 2025.



### 3

## Monitorimi i planit të auditimeve

Plani vjetor i auditimeve për vitin 2025, është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH – së nr. 218, datë 15.11.2024, ku parashikohet realizimi i 180 misioneve të auditimit. Gjatë vitit 2025, KLSH ka evaduar 190 misione auditime, nga 180 të planifikuara, duke tejkaluar planin vjetor të auditimeve në masën 105 %.



### 4

## Mbulimi me auditime i fushave të OZHQ

Në përmbushje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) sipas Axhendës 2030, nëpërmjet punës audituese, në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t, gjatë vitit 2025, Departamenti i Auditimit të Performancës ka kryer këto auditime që mbulojnë fushat e OZHQ-ve, si:

### Për OZHQ 1 “Pa varfëri”

- “Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ - Zhdukja e varfërisë në të gjitha format”;

### Për OZHQ 5 “Barazia gjinore”

- “Përfaqësimi i grave në politikë dhe qeverisje”

### Për OZHQ 6 “Ujë i pastër dhe kanalizime”

- “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhen në treg për qytetarin” Me theks të veçantë në procesin e licencimit, certifikimit dhe tregtimit të ujit të ambalazhuar, për garantimin e cilësisë së tij”;
- “Cilësia e ujërave në plazhe” Fokusuar në mostrajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe ndikimin e tyre në cilësinë dhe ndotjen e ujërave të plazheve”;
- “Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës”;
- “Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë”.

1 NO POVERTY



6 CLEAN WATER AND SANITATION



5 GENDER EQUALITY



# 1.2

## Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit



1

### Adoptimi dhe përditësimi i udhëzuesve/manualeve

Gjatë vitit 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar përpjekjet për forcimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe profesionalizmit në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, përmes adoptimit, përditësimit dhe implementimit të udhëzuesve dhe manualeve përkatëse, në përgjigje të ndryshimeve dhe kërkesave të reja standardizuese. Në këtë kuadër, është ndërmarrë implementimi i ISSAI 140 të rishikuar, përmes vendosjes në funksion të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, bazuar në dokumente të miratuara nga Kryetari i KLSH-së. Procesi i hartimit të dokumenteve të menaxhimit të cilësisë është realizuar nën mbikëqyrjen e vazhdueshme metodologjike të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI), në kuadër të projektit pilot për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, duke garantuar përputhshmërinë e plotë me kërkesat e standardit të rishikuar.

Paketa e menaxhimit të cilësisë përfshin Udhëzuesin për Monitorimin dhe Përmirësimin, Udhëzuesin për Vlerësimin dhe Hartën e Proceseve, si dhe Regjistrin e Riskut të Cilësisë, të cilat rregullojnë mekanizmat e vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë, menaxhimin e rreziqeve dhe përmirësimin sistematik të proceseve audituese, duke konsoliduar kalimin nga kontrolli i cilësisë drejt një qasjeje të integruar të menaxhimit të cilësisë.

Paralelisht, gjatë vitit 2025 është përditësuar dhe miratuar Udhëzuesi për Përcaktimin e Fushave me Risk, i cili ka shërbyer si instrument orientues për planifikimin e veprimtarisë audituese, duke siguruar fokusimin e burimeve institucionale në fushat me nivel më të lartë risku dhe rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve audituese.

Në funksion të këtij objekti dhe të rritjes së cilësisë së auditimit të performancës, gjatë vitit 2025 ka vijuar procesi i rishikimit dhe përditësimit të Manualit të Auditimit të Performancës, i cili është ende në zhvillim, me mbështetjen dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Institucionin Suprem të Auditimit të Norvegjisë. Ky bashkëpunim ka kontribuar në adresimin e aspekteve metodologjike dhe teknike të auditimit të performancës, me synim përmirësimin e cilësisë së gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve audituese. Drafti i Manualit të Auditimit të Performancës parashikohet të përfundojë brenda dhjetëditëshit të parë të muajit prill 2026.



Gjithashtu gjatë vitit 2025 është kryer rishikimi i Manualit për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve, i cili aktualisht ndodhet në fazën përfundimtare të miratimit. Ky proces është ndërmarrë në kuadër të përditësimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit, përmbushjes së objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2023–2027, si dhe zbatimit të rekomandimeve të Komisionit Evropian. Synimi kryesor është vendosja e një metodologjie moderne dhe efikase për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet publike të audituara.

### 3

## Orientimi drejt auditimeve të sistemit

Auditimet mbi bazë sistemi vijojnë të jenë një komponent thelbësor i veprimtarisë së KLSH-së edhe gjatë vitit 2025. Në kushtet e zhvillimeve të vazhdueshme teknologjike, si dhe të kompleksitetit në rritje të sistemeve të administrimit financiar publik, orientimi drejt auditimeve të sistemeve mbetet i domosdoshëm për identifikimin në kohë të dobësive strukturore dhe parandalimin e fenomeneve me ndikim negativ në financat publike, bazuar edhe në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2025, auditimet mbi bazë sistemi janë zhvilluar në fusha kyçe të administrimit publik. Fushat e audituara mbi bazë sistemi përfshijnë: Sistemet e Prokurimeve Publike, Sistemin E-Leje, si dhe Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në ato bashki të cilat disponojnë Programe të Veçanta. Këto auditime kanë synuar vlerësimin e funksionimit të sistemeve, efektivitetin e kontroleve të brendshme, si dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Ndërkohë, për auditimet që zhvillohen nga sektori i Pronës Publike, edhe gjatë vitit 2025 nuk ka qenë e mundur realizimi i auditimit mbi bazë sistemi, për shkak të mungesës së aksesit në sistemin multifunksional. Kjo situatë ka vijuar të kufizojë mundësinë për një vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të funksionimit të këtij sistemi, duke evidentuar nevojën për adresimin e këtij kufizimi në funksion të zgjerimit dhe thellimit të auditimeve mbi bazë sistemi.

### 4

## Modernizimi logjistik

Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ka vijuar bashkëpunimin me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN), me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së auditimeve, përmes workshopeve dhe webinarëve të fokusuar në Sigurinë e Informacionit dhe Sigurinë Kibernetike. Gjatë vitit 2025 është ndërmarrë pilotimi i disa mjeteve IT (Open Source), të përdorura nga OAGN në auditimet e Teknologjisë së Informacionit, veçanërisht në fushën e sigurisë kibernetike. Pilotimi i këtyre mjeteve, i planifikuar fillimisht për infrastrukturën kritike e-Taxation, u shty për një fazë të mëvonshme për të garantuar kushte më të përshtatshme ligjore dhe organizative. Në vijim, mjetet IT u pilotuan në infrastrukturën e KLSH-së, në kuadër të një auditimi në bashkëpunim me ekspertët e OAGN (“Ethical Hacking”), duke mundësuar testimin praktik të tyre dhe rritjen e përgatitjes profesionale të audituesve.



Gjatë vitit 2025 janë realizuar ndryshime madhore në infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), të orientuara drejt optimizimit dhe standardizimit të saj. Në këtë kuadër, është kryer uniformizimi i endpointeve përmes përditësimit në Windows 11 dhe pajisjes me SSD, duke sjellë një rritje të ndjeshme të performancës, si dhe është optimizuar infrastruktura e rrjetit. Paralelisht, janë ngritur politika të avancuara sigurie në përputhje me standardet ndërkombëtare, janë zbatuar rekomandimet e raportit të Ethical Hacking të realizuar nga SAI Norvegji dhe janë respektuar kërkesat e ligjit për sigurinë kibernetike, duke kontribuar në krijimin e një ambienti kibernetik më të qëndrueshëm dhe më të sigurt për institucionin.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është realizuar faqja e re zyrtare e institucionit, e cila vijon të përmirësohet në aspektin e funksionaliteteve dhe të sigurisë, me qëllim garantimin e integritetit, besueshmërisë dhe mbrojtjes së informacionit institucional.

Në të njëjtën kohë, ka vijuar përmirësimi i cilësisë së prodhimit të buletineve dhe i nxjerrjes së statistikave, përmes përdorimit të software-ve bashkëkohore, me fokus rritjen e eficiencës dhe standardizimin e informacionit.

Faqja zyrtare ndodhet ende në proces të implementimit të mjeteve për monitorimin e trafikut, me synim mbledhjen e statistikave të sakta mbi klikimet dhe forcimin e mëtejshëm të sigurisë së saj.



## 5

## Bashkëpunimi me SAI-et homologe, me EUROSAI/ INTOSAI-n dhe institucione ndërkombëtare

Gjatë vitit 2025, KLSH ka vijuar bashkëpunimin me SAI homologe EUROSAI/ INTOSAI – n dhe institucione ndërkombëtare ku përmendim:

### EUROSAI

- Sesioni i punës “Matja e performancës mjedisore në sektorin publik”;
- Sesioni i pranverës i EUROSAI/WGEA me temë “Përshatja e ndryshimeve klimatike dhe zbutja e politikave si sfidë për agrikulturën”;
- Takimi vjetor EUROSAI/WGEA me temë “Lidhja Klime-Ujë-Biodiversitet”;
- Kursi online mbi “Çështjet e ujit” organizuar nga SAI i Estonisë në bashkëpunim me Universitetin e Tartusë;
- Pjesëmarrja online në Konferencën përmblyëse të projektit “Përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës së prokurimit publik” organizuar nga Gjykata Portugeze e Audituesve dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD);
- Webinari për Inteligjencën Artificiale organizuar nga SAI i Suedisë;
- E-seminari i organizuar nga ITWG mbi “Auditimin e Infrastrukturës kritike të Informacionit”;
- Workshop-i rajonal me temë “Auditimet e Teknologjisë së Informacionit – Zhvillimet dhe Sfidat”, organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, ZKA;

### INTOSAI / IDI

- Kongresi XXV i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI);
- Takimi me Presidentin e Gjykatës së Përgjithshme të Auditimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite gjatë aktiviteteve shoqëruese të Kongresit INCOSAI XXV;
- Konferenca XIV UNCTAD “Menaxhimi efektiv dhe elastik i borxhit” organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe INTOSAI;
- Forumi Politik i Nivelit të Lartë të Kombeve të Bashkuara “Rritja e kompetencave të SAI-ve për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”;
- Workshop-i mbi trajnimin e moderatorëve për instrumentin e vetëvlerësimit të integritetit IntoSAINT;

### Vizita zyrtare

- Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së z. Arben Shehu pranë Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë me rastin e 106 – vjetorit të krijimit;
- Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së z. Arben Shehu pranë Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë në kuadër të bashkëpunimit dypalësh;
- Vizita e punës e Kryetarit të KLSH-së z. Arben Shehu pranë Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës në kuadër të auditimit paralel “Mbrojtja dhe siguria e digave”;
- Vizita zyrtare me rastin e 26-vjetorit të SAO-s së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Vizita Studimore e audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Gjykatën Turke të Llogarive me fokus shkëmbimin e eksperiencave në “Auditimin e Sektorit të Sigurisë”;
- Vizitat studimore ndërmjet grupeve të auditimit KLSH-ZKA në kuadër të auditimit paralel “Mbrojtja dhe siguria e digave”;

## Bashkëpunimi me SAI-et homologe, me EUROSAI/ INTOSAI-n dhe institucione ndërkombëtare

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet homologe: janë zhvilluar disa auditime paralele dhe të përbashkëta; ka vijuar bashkëpunimi me SAI-et; si dhe janë zhvilluar takime, workshope e konferenca me partnerë të rëndësishëm.

### Auditime paralele ose të udhëhequra nga SAI-e homologe

- Ka vijuar angazhimi përgjatë vitit 2025 në auditimet paralele mbi: Plakjen e Popullsisë; Mbrojtja dhe Siguria e Digave; Mbi Inteligjencën Artificiale;
- Gjithashtu gjatë vitit 2025 KLSH ka marrë angazhimin për pjesëmarrjen në auditimet paralele dhe të koordinuara si vijon:  
“Menaxhimi i risqeve nga përmbytjet - Vlerësimi i përdorimit të të dhënave hidrometeorologjike për përgatitjen ndaj fatkeqësive” i cili do të zhvillohet përgjatë vitit 2026;  
“Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve” si pjesë e projektit të përbashkët me ZKA të Kosovës dhe SAO të Maqedonisë së Veriut dhe në bashkëpunim me UN Women;

### Marrëveshje bashkëpunimi

- Memorandumin i Mirëkuptimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women);
  - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Dhomës së Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit;
- Peer Review:
- SIGMA zhvilloi procesin Peer Review në KLSH gjatë muajve janar-shkurt 2025 .

### Të tjera

- Angazhimi për anëtarësimin në Task Forcën e EUROSAI-t mbi Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm drejtuar nga Gjykata Turke e Llogarive;
- Projekti rajonal “Smart Finance” për një Qeverisje të Përgjegjshme mbi auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm organizuar nga UNDP;
- Programi pilot “Keqpërdorimi IT në krimet financiare” organizuar nga OECD dhe Guardia di Finanza;
- Konferenca me temë “Mbrojtja” organizuar nga Gjykata Evropiane e Audituesve;
- Trajnimi ndërkombëtar mbi “Vlerësimin e Performancës së Menaxhimit të Borxhit Publik (DeMPA)” organizuar nga World Bank dhe Joint Vienna Institute – JVI”;

## BASHKEPUNIME TE TJERA:

- Takimi III i Grupit të Punës së EUROSAT/ SGI për Auditimet në kohë reale;
- Konferencën e parë ndërkombëtare mbi auditimin paralel “Plakja e Popullsisë” nën organizimin e koordinatorit të kësaj iniciative, SAI-t të Izraelit;
- Konferenca rajonale mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit” organizuar nga SAI i Bosnje dhe Hercegovinës;
- Seminari i organizuar nga Gjykata Portugeze e Llogarive, në kuadër të rrjetit të EUROSAT-t për Etikën (N.ET) me temë “Institucionet Supreme të Auditimit, Inteligjenca Artificiale dhe Etika”;
- Workshop-i VIII i projektit të EUROSAT-t mbi “Data Envelopment Analysis (DEA) dhe metodat e tjera të krahasimit”;
- Takimi i EUROSAT WGEA për bashkëpunimin ndërkombëtar në auditimin me temë “Përshtatja e menaxhimit të pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike” organizuar nga NIK i Polonisë;
- Workshop-i ndërkombëtar “EUROSAT Development Activities Project launch and Audit Impact Workshop”, që shënon nisjen zyrtare të projektit të ri zhvillimor të EUROSAT-t (EDA) organizuar nga SAI i Suedisë.
- .....
- Webinari ndërkombëtar “Rojtarët e Përgjegjshmërisë Publike: Kultura e Auditimit dhe Evolucioni Institucional” organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Tajlandës;
- Trajnimi “Auditimi i Sistemeve të Informacionit dhe Auditimi i eQeverisjes” në Qendrën Ndërkombëtare për Sistemet e Informacionit dhe Auditimit (ICISA) në Noida, Indi;
- Trajnimi “Përdorimi i të dhënave analitike dhe teknologjisë në auditim” në Qendrën Ndërkombëtare për Sistemet e Informacionit dhe Auditimit (ICISA) në Noida, Indi;
- Workshopi i avancuar mbi Kornizën e Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI PMF), i organizuar nga INTOSAT Development Initiative (IDI).
- .....
- Konferenca “Integriteti, Transparenca dhe Inovacioni në prokurimin publik” në kuadër të projektit të BE-së “A.C.T – Anti – Corruption in Tenders” për forcimin e integritetit, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes;
- Workshop-i rajonal “Për Ndërtimin e Kapaciteteve në Menaxhimin Financiar të Projekteve (PFM)” nga Banka Islamike për Zhvillim;
- Takimi i nivelit të lartë mbi Zhvillimin e Kapaciteteve organizuar nga UNCTAD/IDI;

- Programi i Trajnimit për Auditimin e Performancës, i organizuar nga Zyra Suedeze e Auditimit (SNAO) ku KLSH merr pjesë me auditimin e performancës “Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit”;
- Internshipi pranë Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Sesionit i prezantimit të Udhëzuesit për Auditimin e Ndjeshëm Gjikor përparatur nga UN Women Albania;
- Workshop-i me temë “Prokurimi publik dhe monitorimi qytetar”, organizuar si takim iniciues në kuadër të projektit “iMonitor 2.0”, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian;
- Në kuadër të bashkëpunimit me OAGN të Norvegjisë, janë përmbyllur si vijon:
  - auditimet "Cilësia e Ujërave në Plazhe" dhe "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar";
  - trajnimi "External cyber security for web and external interfaces";
  - workshop-i “Internal ethical hacking of ALSAI”;
  - Workshop II mbi “Cyber Security”;
  - sesionet e punës mbi përditësimin e manualit të performances.
- Bashkëpunimi me IDI-n:
  - në programin profesional PESA-P;
  - në programin mbi certifikimin e specialistëve për “Menaxhimin e Cilësisë në Auditim” SoAQM në kuadër të rishikimit të ISSAI 140;
  - sesionet e trajnimit në kuadër të misionit mbështetës të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për Gjykatën e Llogarive të Timor Leste mbi SoAQM;
  - sesionet e trajnimit në kuadër të misionit mbështetës të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) mbi rishikimin e pavarur të SAI PFM;
- Bashkëpunimi me UKNAO dhe me WFD Albania mbi “Zhvillimin e kornizës së Komunikimit Strategjik dhe përmirësimit të funksioneve kryesore të komunikimit’.
- .....
- “Përshtatja e menaxhimit të pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike” në kuadër të anëtarësimit në Grupin e Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Mjedisit/WGEA;
- “Cilësia e Hapësirave Publike Urbane” në kuadër të anëtarësimit në Grupin e Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive/WGMA.

## 1.3 Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin

### 1 Dëgjesat e zhvilluara dhe raportet e auditimit të përcjella në Kuvend

KLSH ka vijuar të intensifikojë komunikimin dhe bashkëpunimin me Kuvendin, duke përcjellë vazhdimisht raporte auditimi në Kuvend. Gjatë vitit 2025, KLSH ka përcjellë në Kuvend, 186 raporte auditimi, Raporti Vjetor i Performancës për vitin 2024, si dhe Raporti mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2024. Gjithashtu, Kuvendi është informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së 3 buletineve statistikore periodike, 3 raporteve të zbatimit të rekomandimeve, si dhe të 12 buletineve informuese mujore të KLSH-së.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar nga Nënkomisioni dhe përfaqësues të KLSH-së, seancat e mëposhtme:

- Seanca dëgjimore e datës 28.01.2025, mbi miratimin e projektvendimit të Nënkomisionit “Për shpalljen e procedurës përzgjedhëse të grupit të audituesve të pavarur, të cilët do të auditojnë llogaritë financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Seanca dëgjimore e datës 11.02.2025, ku u prezantua raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e ushtruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë vendore të saj për periudhën 2022-2023.
- Seanca dëgjimore e datës 12.03.2025 me Subjektet e Audituar, mbi Planin e Masave për zbatimin e rekomandimeve dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e ushtruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë vendore të saj për periudhën 2022-2023;
- Seanca dëgjimore e datës 09.06.2025, mbi miratimin e raportit të Nënkomisionit “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e ushtruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë vendore të saj për periudhën 2022-2023”.



## KLSH dhe Kuvendi



Me synimin për të forcuar bashkëpunimin institucional, gjatë vitit 2025 janë realizuar disa aktivitete të përbashkëta mes Kuvendit dhe KLSH-së, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të dy institucioneve. Ndërkohë, bashkëpunimi ndërmjet KLSH-së dhe Kuvendit është thelluar edhe gjatë vitit 2025, duke u formalizuar dhe konsoliduar më tej përmes Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025, KLSH mori pjesë në disa aktivitete me Kuvendin:

- Më 20.05.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit festoi 100-vjetorin e themelimit në një ceremoni solemne të zhvilluar në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e drejtuesve të lartë shtetërorë, përfaqësuesve diplomatikë, institucioneve supreme të auditimit dhe partnerëve ndërkombëtarë.

- Më 29.10.2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, prezantoi Raportin Vjetor të Veprimtarisë për vitin 2024 në mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

- Më 04.11.2025, Kryetari i KLSH-së paraqiti Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2024 në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

- Më 06.11.2025, Kryetari i KLSH-së raportoi në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë mbi veprimtarinë e institucionit për vitin 2024.

- Më 13.11.2025, KLSH paraqiti kërkesat për projektbuxhetin e vitit 2026 në seancën dëgjimore të Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

- Në datat 16–17.12.2025, Instituti Demokratik Amerikan (NDI) organizoi një tryezë diskutimi mbi forcimin e partneritetit konstruktiv ndërmjet Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik dhe KLSH-së.

## Raportet e zbatimit të rekomandimeve

KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrit të Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, tre raporte përmbljedhëse:

- “Raportin përmbljedhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve” (Përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 282 dhe 282/1 prot., datë 25.02.2025)
- “Raportin përmbljedhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve” (Përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 282/2 dhe 282/3 prot., datë 04.07.2025)
- “Raportin përmbljedhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve” (Përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 282/4 dhe 282/5 prot., datë 18.12.2025)



### 3. Plotësimi periodik i Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit mbi zbatimin e rekomandimeve

Gjatë vitit 2025, raportimi dhe ndjekja e rekomandimeve të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit drejt Kuvendit u realizuan përmes komunikimit shkresor. Në këtë kuadër, informacionet dhe të dhënat e kërkuara nga Kuvendi, lidhur me rekomandimet dhe ecurinë e zbatimit të tyre, u përcollën nga KLSH në përputhje me kërkesat zyrtare të adresuara.

Ky proces komunikimi u mbështet në dokumentacionin e shkruar dhe në shkëmbimin elektronik të shkresave, duke garantuar dhënien e informacionit sipas procedurave administrative në fuqi dhe praktikës institucionale të ndjekur gjatë vitit 2025.

Aktualisht, Platforma Ndërinstitucionale Online e Kuvendit shërben për konsultimin e të dhënave të hedhura më parë në sistem, ndërkohë që pasurimi i saj me materiale të reja mbetet i kufizuar.

## QËLLIMI 2



### RRITJA E IMPAKTIT TË PUNËS AUDITUESE NË QEVERISJEN E MIRË NËPËRMJET PËRMIRËSIMIT TË NIVELIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH, synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në qeverisjen e mirë, nxitjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së përdorimit të fondeve publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve praktike, të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete, për përmirësimin e situatës së konstatuar dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Monitorimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara, në bashkëpunim edhe me Kuvendin, me qëllim nxitjen e institucioneve publike për zbatimin e tyre, është treguesi kryesor për matjen e impaktit të punës audituese.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet pesë objektivave të mëposhtme:

**2.1**

Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit

**2.2**

Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese

**2.3**

Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së

**2.4**

Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin

**2.5**

Përdorimi i teknikave të të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive

## 2.1 Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit

KLSH ka paraqitur dhe komunikuar punën audituese duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari. Në funksion të misionit që ka, KLSH synon t'u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve, duke u ofruar mundësinë dhe aksesin e plotë në informacion për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, që është mirëqeverisja.

### 1 Publikimi dhe promovimi i raporteve të auditimit nëpërmjet broshurave

Gjatë vitit 2025, krahas Raportit Vjetor të Performancës për vitin 2024, si dhe Raportit mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2024, KLSH ka përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë, 186 raporte përfundimtare auditimi. Gjatë vitit 2025, në faqen zyrtare të KLSH-së janë publikuar 190 raporte përfundimtare auditimi.



01 Broshura “100 vjet KLSH”

02 Fletëpalosja informuese me rastin e 100-vjetorit”

03 Album “Aktivitetet e 100-vjetorit”

04 Buletini Vjetor 2025

05 12 buletinet informuese mujore <https://klsh.org.al/buletine-informuese/>  
Materialet janë përgatitur dhe publikuar në web në shqip dhe anglisht.



## 2

### Promovimi i raporteve të auditimit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve



Në kuadër të promovimit të raporteve të auditimit Departamenti i Auditimit të Performancës përgjatë vitit 2025 ka vijuar bashkëpunimin duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të përbashkëta dhe duke realizuar disa auditime paralele ose me mbështetjen e Institucioneve Supreme të Auditimit të Norvegjisë, Suedisë etj. Më konkretisht, përgjatë 2025 janë finalizuar auditimet e performancës me temë “Cilësia e ujërave në plazhe”, “Shërbimi Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar” të cilat janë asistuar nga Institucioni Suprem i Auditimit të Norvegjisë. Auditimi paralel i performancës me temë “Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim” është zhvilluar në bashkëpunim me SAI-n e Izraelit, ku kanë marrë pjesë edhe disa SAI të tjera nga rajoni e më gjerë. Në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës është realizuar auditimi “Mbrotjtja dhe siguria e digave”. Auditimi me temë “Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit” i cili është ende në proces dhe pritet të përfundojë në mars 2026, është duke u zhvilluar me mbështetjen e SAI-t të Suedisë. Krahas këtyre auditimeve, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe Institucionin Suprem të Auditimit të Maqedonisë së Veriut është duke u zhvilluar auditimi paralel me temë “Përfaqësimi i grave në politikë dhe qeverisje” i cili pritet të përfundojë brenda gjashtëmujorit të parë të 2026.

## 3

### Artikuj dhe kronika në median audiovizive mbi veprimtarinë e KLSH

Gjatë vitit 2025, në media janë publikuar 1115 artikuj, kryesisht mbi veprimtarinë audituese të KLSH-së. Ndarë në mënyrë të detajuar si më poshtë:

**96 artikuj në shtypin e shkruar**

**914 kronika dhe artikuj në median audiovizive dhe online**


**105 kronika dhe emisione televizive**



## 4

### Pasurimi i faqes së web-it

Faqja zyrtare e institucionit ka shënuar një përmirësim të qëndrueshëm dhe të strukturuar në drejtim të pasurimit të përmbajtjes dhe rritjes së funksionalitetit të saj, duke reflektuar një angazhim më të madh për transparencë, aksesueshmëri dhe komunikim efektiv me publikun vendas dhe ndërkombëtar. Përditësimi i vazhdueshëm i informacionit, riorganizimi i përmbajtjes dhe përdorimi i një qasjeje më të qartë informative kanë ndikuar në lehtësimin e navigimit dhe në rritjen e kuptueshmërisë së të dhënave të publikuara. Gjithashtu, vëmendja ndaj standardeve të komunikimit institucional dhe përshtatja e përmbajtjes për një audiencë më të gjerë kanë kontribuar në forcimin e imazhit institucional dhe në përmirësimin e ndërveprimit me palët e interesuara. Në këtë kuadër, faqja e internetit po konsolidohet si një mjet funksional dhe i besueshëm informimi, duke mbështetur objektivat e monitorimit, llogaridhënies dhe transparencës, si dhe duke krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillime të mëtejshme në përputhje me praktikën më të mira institucionale.



## 5

### Administrimi i ankesave dhe kërkesave

Administrimi i ankesave dhe kërkesave për informacion gjatë periudhës së monitoruar është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet institucionale, duke reflektuar një qasje të strukturuar dhe funksionale. Në drejtim të komunikimit me qytetarët janë administruar gjithsej 189 ankesa letra/ankesa nga individë dhe subjekte të ndryshme, ndër të cilat 11 kërkesa për informacion (6 përfaqësues të medias dhe 5 qytetarë). Struktura përgjegjëse për të drejtën e informimit i ka trajtuar këto komunikime, në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara.



## 2.2 Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese

Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese i shton vlerë punës audituese, duke raportuar rastet korruptive të konstatuara nga KLSH. Për këtë qëllim, KLSH ka synuar rritjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë vitit 2025 përfaqësues të institucionit kanë marrë pjesë në aktivitete dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga OJF me qëllim luftën kundër korrupsionit, si vijon:

**01** Më datë 7 prill 2025 në kuadër të misionit të vlerësimit për “Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu priti në takim ekspertët e Komisionit Europian, në të cilin nënvizoi angazhimin e KLSH-së për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore dhe institucionale, duke siguruar bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet ligjzbatuese.

**02** Më datën 18 korrik 2025, KLSH merr pjesë në tryezën e rrumbullakët “Korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri” e cila organizua në ambientet e “Libraria Tirana Times” në Tiranë, organizuar nga shoqëria civile, ku morën pjesë përfaqësues të medias dhe të shoqatave të ndryshme në sektorin e shëndetësisë.

**03** Më datën 29.10.2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, zhvillon një takim me përfaqësues të Njesisë Speciale Antikorrupsion të Guardia di Finanza zhvilloi me Gjeneralin B. Giovanni Salerno, Komandant I Njesisë Speciale Antikorrupsion të Guardia di Finanza dhe përgjegjës për sigurimin e ligjshmërisë në administratën publike, si dhe Kolonelin Giampiero Carrieri, ekspert i Guardia di Finanza për Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi, pranë Ambasadës së Italisë në Tiranë.

**04** Më 24 tetor 2025 u mbajt në Leçe, Itali, konferenca ndërkombëtare me temë “Integriteti, Transparenca dhe Inovacioni në Prokurimin Publik”, ku u paraqit modeli Italian dhe një krahasim me sistemin shqiptar”. Kjo konferencë u zhvillua në kuadër të projektit “A.C.T. – Kundër Korrupsionit në Tendera”, i financuar nga Programi Interreg IPASouth Adriatic. Projekti synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, për parandalimin e korrupsionit dhe garantimin e transparencës në prokurimet publike, përmes krijimit të mjeteve të përbashkëta, trajnimit të zyrtarëve dhe përhapjes së praktikave të mira administrative dhe ligjore. Ndër të tjera, u theksua bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me institucione të tjera, si: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm etj.

## 2.3 Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së

Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së mbështetet në kuadrin kushtetues dhe ligjor, ku roli dhe funksionet e institucionit janë të sanksionuara qartë në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik, duke garantuar ushtrimin e veprimtarisë audituese në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik, institucioni ka ndërmarrë procese të brendshme për rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues, me qëllim vlerësimin e nevojës për përditësime dhe përshtatje në funksion të forcimit të mëtejshëm të mandatit institucional. Këto procese kanë përfshirë angazhimin e strukturave përkatëse dhe konsultime për hartimin e propozimeve konkrete, ndërsa gjatë periudhës së fundit nuk janë shënuar zhvillime të reja në drejtim të ndryshimeve ligjore, pa reflektuar një fazë konsolidimi të situatës ekzistuese dhe fokus në zbatimin e mandatit aktual në përputhje me objektivat strategjike.



## 2.4 Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin

Hartimi i raporteve të auditimit ka vijuar të fokusohet në rritjen e qartësisë, kuptueshmërisë dhe relevancës së informacionit të përcjellë, me synim adresimin efektiv të nevojave të një audience të gjerë lexuesish. Në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, raportet janë strukturuar në mënyrë të tillë që rezultatet dhe gjetjet të paraqiten me gjuhë të qartë, të saktë dhe profesionale, duke lehtësuar interpretimin e tyre edhe nga përdorues që nuk kanë njohuri të specializuara në fushën e auditimit. Kjo qasje ka kontribuar në forcimin e transparencës së procesit auditues, në rritjen e besueshmërisë së raporteve dhe në përmirësimin e përdorimit të tyre si instrument informimi për vendimmarrje dhe llogaridhënie, duke mbështetur njëkohësisht përgjegjshmërinë në menaxhimin e burimeve publike

### 1

#### Shkrimi dhe redaktimi i raporteve në KLSH

Shkrimi dhe redaktimi i raporteve në KLSH kanë shënuar përmirësime të dukshme në drejtim të standardizimit të gjuhës dhe rritjes së kuptueshmërisë për lexuesin, duke reflektuar një qasje më të strukturuar dhe profesionale në komunikimin e rezultateve të auditimit. Zbatimi i udhëzimeve përkatëse ka ndikuar në unifikimin e stilit të raportimit, në qartësimin e mesazheve kryesore dhe në shmangien e formulimeve teknike të panevojshme, pa cenuar saktësinë profesionale. Bashkëpunimi ndërmjet strukturave përgjegjëse për redaktimin dhe komunikimin ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së raporteve, duke i bërë ato më të aksesueshme dhe më të dobishme për publikun dhe palët e interesuara, si dhe duke forcuar rolin e tyre si instrumente transparence dhe llogaridhënieje institucionale. Megjithatë, mbetet e nevojshme përmirësimi i mënyrës së shprehjes, me qëllim formulimin më të thjeshtë, më të qartë dhe të përqendruar në thelbin e konstatimeve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, janë kryer trajnime të vazhdueshme në lidhje me shkrimin e raporteve, procedurat e auditimit, të organizuara nga Departamenti i Metodologjisë Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.



## 2

### Përdorimi i aplikacioneve me qëllim aplikimin e infografikëve

Gjatë vitit 2025, janë përdorur programe të dedikuara që lejojnë krijimin e infografikëve dhe vizualizimeve, nëpërmjet të cilave janë prodhuar dokumente cilësore dhe profesionale si: Politika e Menaxhimit të Cilësisë në KLSH; Udhëzuesi i Menaxhimit të Riskut të Cilësisë; Buletinet statistikore; Broshura për Javën e Integritetit; Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve; Buletinet statistikore; Raportet mbi zbatimin e rekomandimeve, etj. Këto programe do të vijojnë të përdoren edhe për implementimin e infografikëve edhe në dokumenta të rëndësishëm si Raporti i Performancës së KLSH-së, Raporti Vjetor i Implementimit të Strategjisë 2023-2027, si dhe në raste të veçanta sipas nevojës.



## 3

### Hartimi i rekomandimeve të kuptueshme dhe të matshme

Rekomandimet përfaqësojnë një element thelbësor në përpjekjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të auditimit dhe rritjen e cilësisë së produkteve audituese. Për këtë, gjatë vitit 2025, është rishikuar manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe ky manual ndodhet në fazën finale të miratimit. Ky proces lidhet me rishikimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, realizimin e objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027 dhe zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, duke synuar vendosjen e një metodologjie bashkëkohore për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara.

Gjatë vitit 2025 është përmirësuar procesi i hartimit të rekomandimeve përmes përdorimit të teknikave të shkrimit profesional, duke i formuluar ato në mënyrë më të qartë dhe të realizueshme. Rekomandimet janë orientuar drejt adresimit të shkaqeve të problematikave të evidentuara dhe jo vetëm të pasojave të tyre; megjithatë, në një numër rastesh vihet re se ato fokusohen kryesisht në përmirësime të situatës në të ardhmen, pa ofruar zgjidhje konkrete për problemin e konstatuar aktualisht. Në këtë këndvështrim, bëhet më i vështirë vlerësimi dhe matja e nivelit të impaktit të rekomandimeve.



## 2.5


### Përdorimi i teknikave të të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive

#### 1

#### Pranueshmëria dhe zbatueshmëria e rekomandimeve

Nga 125 auditimet e kryera nga KLSH gjatë viteve 2023–2024 janë dhënë gjithsej 4348 masa, nga të cilat 4294 masa (rreth 99%) janë pranuar dhe 54 masa (rreth 1%) nuk janë pranuar. Masat përfshijnë kryesisht masa organizative, masa disiplinore dhe masa me efekte financiare. Nga totali i masave të pranuar, 1598 masa (37%) janë zbatuar plotësisht, 645 masa (15%) janë zbatuar pjesërisht, 746 masa (17%) janë në proces zbatimi, ndërsa 1305 masa (30%) rezultojnë ende të pazbatuara.

Të dhënat tregojnë se, megjithëse niveli i pranimit të masave të rekomanduara është shumë i lartë, zbatimi i tyre mbetet i pjesshëm, me një pjesë të konsiderueshme masash ende në proces ose të pazbatuara, çka nënvizon rëndësinë e ndjekjes së vazhdueshme për rritjen e efektivitetit të auditimit.



# QËLLIMI 3



## OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE ME QËLLIM ZOTËRIMIN E NJOHURIVE INOVATIVE NË PUNËN AUDITUESE

Në përputhje me misionin, vizionin dhe Strategjinë Institucionale 2023 - 2027, KLSH vlerëson vazhdimisht efektivitetin dhe përshtatshmërinë e burimeve të nevojshme për të përmbushur mandatin (si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë), dhe për të arritur aspiratat institucionale, duke i integruar këto në kulturën organizative të institucionit. Ky qëllim synon, përveç zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të krijojë një mjedis pune pozitiv, të qëndrueshëm dhe shpërblyes që nxit rezultate në sfida inovative.

KLSH investon në përmirësimin e aftësive të audituesve, në përdorimin e teknologjisë dhe analizimin e të dhënave (big data), për të kryer auditime më të thelluara të bazuara në sistem. Kjo përfshin komunikimin e rezultateve në forma më të kuptueshme dhe inovative, si dhe rritjen e aftësisë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj rrethanave që mund të lindin nga situata emergjente, si ato me të cilat u përballëm në vitet e fundit.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet tre objektivave të mëposhtme:

**3.1** Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave

**3.2** Krijimi i një ambienti stimulues, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari

**3.3** Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model


# 3.1 Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave

## 1 Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve

Nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, KLSH ka vijuar gjatë vitit 2025 forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus të veçantë në audituesit, në funksion të realizimit të objektivave institucionale dhe strategjike. Departamenti i Metodologjisë ka kryer në mënyrë periodike analizën e nevojave për trajnim dhe ka zhvilluar programe trajnimi në përputhje me Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, të miratuar me Vendimin nr. 18, datë 21.01.2025 të Kryetarit të KLSH-së.

Trajnimet janë realizuar si në nivel të brendshëm, ashtu edhe në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të stafit dhe rritjen e cilësisë së punës audituese, transparencës dhe mirëqeverisjes në përdorimin e fondeve publike.

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë realizuar gjithsej 137 tema trajnimi, nga të cilat 29 tema janë zhvilluar nga ASPA, 55 tema nga KLSH dhe 53 tema nga partnerë ndërkombëtarë, përfshirë EUROSAT, IDI, SAI i Norvegjisë, ANAC, OECD, etj.



Në total janë trajnuar 199 punonjës, auditues dhe jo-auditues, duke realizuar 5195 ditë-njerëz trajnimi, nga të cilat 4215 ditë-njerëz trajnimi për 153 staf auditues dhe 980 ditë-njerëz trajnimi për 46 staf jo-auditues. Mesatarisht janë realizuar 27.5 ditë trajnimi për staf auditues dhe 21.3 ditë trajnimi për stafin jo-auditues, duke tejkalluar objektivat minimale vjetore të përcaktuara për të dy kategoritë.

Procesi i planifikimit vjetor të auditimeve ka ndjekur një qasje nga poshtë-lart, ku audituesit kanë propozuar tema auditimi të bazuara në njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimeve dhe zhvillimit profesional. Këto propozime janë vlerësuar në bazë të riskut dhe prioriteteve institucionale dhe janë përzgjedhur nga nivelet drejtuese, duke reflektuar ndikimin e drejtpërdrejtë të zhvillimit profesional në përmirësimin e procesit të auditimit.

## 2

### Bashkëpunimi me ECA/GAO dhe homologë për forcim kapacitetesh

KLSH ka vijuar bashkëpunimin e strukturuar me institucionet homologe ndërkombëtare, përfshirë Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA), Zyrën e Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara (GAO) dhe institucione të tjera homologe, me qëllim forcimin e kapaciteteve audituese dhe shkëmbimin e praktikave më të mira profesionale. Referuar Deklaratës së Rios 2022, nxitja e një zëri global më efektiv dhe reagimi ndaj ndryshimit të mjedisit dhe risqeve, kërkon që SAI-t, të përmirësojnë mënyrën se si punojnë së bashku dhe të angazhohen me palët e interesuara. Gjatë vitit 2025, KLSH ka vijuar bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në programe intership-i me institucionet homologe. Në këtë kuadër, në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) ka ndjekur programin e intership-it një auditues. Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2025 vazhdojnë të zhvillohen trajnime me qëllim ndarjen e eksperiencës dhe shkëmbimin e praktikave më të mira me kolegët.




## 3.2 Krijimi i një ambienti stimules, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari

Gjatë vitit 2025, KLSH ka vijuar ndërtimin e një mjedisi pune stimules, sfidues dhe shpërblyes, duke e mbështetur këtë proces në menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore. Politikat e zhvillimit dhe motivimit të stafit janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme, duke kontribuar në forcimin e kulturës pozitive të punës, rritjen e angazhimit dhe përmirësimin e performancës institucionale.

Stafi drejtues, ku përfshihen Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor i Kabinetit, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive, Këshilltarë dhe Përgjegjës Sektori përbën rreth 13% të numrit total faktik të punonjësve ose 28 punonjës; stafi auditues (Kryeauditues dhe Auditues) përbën 72% të numrit total faktik të punonjësve ose 154 punonjës; stafi mbështetës (Specialistë, juristë, punonjës shërbimi, etj.) përbën rreth 15% të numrit total faktik të punonjësve, ose 33 punonjës.

### Përbërja stukturore e stafit sipas funksioneve



KLSH, në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore i ka kushtuar vëmendjen e duhur respektimit të parimit të barazisë gjinore në të gjitha politikat, aspektet apo veprimtaritë institucionale, duke synuar eliminimin e fenomeneve të diskriminimit për shkak të gjinisë. Raporti i punonjësve femra/meshkuj është përmirësuar duke arritur në raport të barabartë në vitin 2025. Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gjinisë femërore, reflektohet në numrin e konsiderueshëm që femrat zënë në të gjitha nivelet drejtuese, duke përfaqësuar 62% të pozicioneve drejtuese (24 pozicione drejtuese kundrejt 39 drejtues në total), si Sekretare e Përgjithshme, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie, Kryeaudituese, Përgjegjëse Sektori dhe Këshilltare.

Me qëllim motivimin dhe shpërblimin e punonjësve, gjatë vitit 2025 në KLSH:

- audituesit kanë ndjekur trajnime brenda dhe jashtë vendit duke zhvilluar njohuritë e tyre në fusha specifike të auditimit të jashtëm publik, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
- audituesit janë promovuar nëpërmjet ngritjes në detyrë; si dhe
- nëpërmjet rotacionit në punë, auditues të ndryshëm kanë përfituar njohuri dhe ekspertizë në fusha të ndryshme auditimi, e cila njëkohësisht u ka shërbyer për nxitje dhe zhvillim profesional dhe personal.

### 3.3 Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2023-2027, gjatë vitit 2025 KLSH ka vijuar monitorimin sistematik të planit të veprimit për implementimin e strategjisë, me qëllim rritjen e vlerës së shtuar të veprimtarisë audituese. Procesi i monitorimit është realizuar në mënyrë periodike dhe të strukturuar, duke u fokusuar në vlerësimin e progresit të arritur, identifikimin e devijimeve nga objektivat e planifikuara dhe adresimin e problematikave të konstatuara. Në këtë kuadër, rezultatet e monitorimit kanë shërbyer si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të punës, rritjen e eficiencës institucionale dhe orientimin e masave korrigjuese në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike të KLSH-së.



# OBJEKTIVAT E PAREALIZUARA DHE NË PROCES

## 1 Objektiva të porealizuara

Referuar Planit strategjik të KLSH, 2023-2027, ku 3 qëllimet strategjike janë detajuar në 11 objektiva, 30 nënobjektiva dhe këto të fundit në 60 tregues performance, rezultoi se për vitin 2025 janë realizuar:

- 3 nga 60 tregues performance i përkasin aktiviteteve të përfunduara në vitin 2023;
- nga 57 tregues janë realizuar 54 tregues ose 95% ;
- pa realizuar 3 nga 57 tregues të matur për vitin 2025 ose 5%.

Treguesit e porealizuar janë:

1. Përgatitja e Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit;
2. Pilotimi i Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit;
3. Ringritja e grupit për hartimin e propozimeve për ndryshime në ligjin për KLSH nr. 154/2014, duke përfshirë ekspertë të fushës si dhe ekspertizë të organizatave si SIGMA, IDI, SAI i Norvegjisë, etj partnerë ndërkombëtarë.

*Për këta tregues do të vijojë puna me qëllim realizimin e tyre gjatë vitit 2026*

## 2 Në proces realizimi

### • Rishikimi i Manualit të Performancës

Rishikimi i Manualit të Auditimit të Performancës, i nisur në vitin 2025, është në proces. Gjatë periudhës raportuese është zhvilluar takimi i dytë në KLSH me SAI-n e Norvegjisë për diskutimin e çështjeve teknike, ndërsa drafti pritet të përfundojë në 10-ditëshin e parë të muajit prill 2026.

### • Rishikimi i Manualit të Zbatimit të Rekomandimeve

Gjatë vitit 2025, Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve është rishikuar dhe ndodhet në fazën finale të miratimit. Ky proces lidhet me rishikimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, realizimin e objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2023–2027 dhe zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, duke synuar vendosjen e një metodologjie bashkëkohore për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara.

# ANEKSE

## Aneks 1: Objektivat e realizuara për vitin 2025

QËLLIMI/NËN OBJEKTIVI	KPI
<b>Qëllimi 1:</b> Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve	19
1.1 Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore	6
1.2 Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit	7
1.3 Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin	6
<b>Qëllimi 2 :</b> Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	28
2.1 Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit	12
2.2 Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese	3
2.4 Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin	10
2.5 Përdorimi i teknikave të të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive	3
<b>Qëllimi 3:</b> Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese	10
3.1 Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave	4
3.2 Krijimi i një ambienti stimulues, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari	5
3.3 Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model	1
<b>Total</b>	<b>57</b>

## Aneks I: Aktivitetet e parealizuara për vitin 2025

QËLLIMI/AKTIVITETET	KPI
<b>Qëllimi 1:</b> Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve	2
Përgatitja e Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit	1
Pilotimi i Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit	1
<b>Qëllimi 2:</b> Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	1
Ri ngritja e grupit për hartimin e propozimeve për ndryshime në ligjin për KLSH nr. 154/2014, duke përfshirë ekspertë të fushës si dhe ekspertizë të organizatave si SIGMA, IDI, SAI i Norvegjisë, etj partnerë ndërkombëtarë.	1
<b>TOTAL</b>	<b>3</b>



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

*Të dhënat mbi realizimin e objektivave të strategjisë, janë raportuar nga departamentet e auditimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse për realizimin e objektivave, dhe janë mbledhur dhe përpunuar nga Departamenti i Metodologjisë, dhe Planifikimit Strategjik .*

*Raporti i monitorimit është përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë dhe Planifikimit Strategjik.*

*Ky raport përfshin linqe ndërevepruese që mbështesin përmbajtjen. Për të aksesuar këtë funksion, ju lutemi shikoni versionin dixhital të këtij raporti në [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al).*



Rruga "Abdi  
Toptani" Nr.1 Tiranë



[klsh.org.al](http://klsh.org.al)



+355 4 2247294



[klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)